



**Shqyrtimi i Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE5)  
Aplikacioni për Tarifa - Plotësime**

8 shkurt 2011

## 1. Hyrje

KOSTT ka pranuar nga ZRrE njoftimin lidhur me planin e realizimit të shqyrtimit të pestë të tarifave të energjisë elektrike (SHTE5) që ka të bëjë me tarifat dhe ngarkesat e reja që do të hyjnë në fuqi dhe do të zbatohen nga data 1 prill 2010.

Me datë 28 janar 2011, KOSTT ka dërguar në ZRrE Aplikacionin për Tarifa. Pas dërgimit të këtij aplikacioni janë vërejtur disa gabime teknike si dhe kanë ndodhur disa ndryshime.

KOSTT fillimisht shpreh keqardhje për lëshimet e bëra.

Sqarimet janë dhënë në vijim.

### Lëshimet Teknike

Në Modelin Tarifor ( të dy versionet ), në faqen KOSTT tek pjesa e Shpenzimeve Operative, respektivisht Materiale dhe Shërbime ( rreshti 17, kolona F ) si dhe Shpenzime tjera ( rreshti 21, kolona F ) vlerat e paraqitura janë gabim. Këto vlera janë zëvendësuar me vlerat e sakta.

Actual 2010	X	√
Materials/ services	52	37
Other overheads	1,432	1,190

### Humbjet në Transmision

Pas korrigjimeve të cilat janë bërë në Bilancin e Realizuar të Energjisë, vlera e Humbjeve në Transmision në vitin 2010 është 131 GWh. Korrigjimet në Modelin Tarifor ( të dy versionet janë bërë në bazë të sqarimeve të dhëna më poshtë.

Sipas Shqyrtimit të Katërt Tarifor për vitin 2010, përqindja e humbjeve në transmision ka qenë 3.1%, ndërsa energjia e parashikuar në disponim ishte 5316.6 GWh. Si rezultat volumi i humbjeve të lejuara është paraqitur 166 GWh.

Energjia e matur në vitin 2010 tregon rrjedha më të mëdha se sa ato të parashikuara, respektivisht energjia në disponim gjatë vitit 2010 ka qenë 5590.2 GWh, çka rezulton në rritjen e volumit të humbjeve të lejuara në 175 GWh. Humbjet e matura në transmision gjatë vitit 2010 janë 131 GWh. Siç po shihet, KOSTT me një efikasitet të ngritur ka arritur t'i zvogëlojë humbjet në transmision ndaj atyre të lejuara për 44 GWh.

Kërkesa e KOSTT për humbjet në transmision të vitit 2011 është e bazuar në qasjen stimuluese të përcaktuar nga Metodologjia Tarifore. Volumi i kërkuar është 153 GWh. Kjo vlerë paraqet humbjet aktuale të vitit 2010 plus gjysmën e volumit të humbjeve të zvogëluara.

$$131 \text{ GWh} + \frac{1}{2} 44 \text{ GWh} = 153 \text{ GWh}$$

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-CLRR-032</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 4</i>

### Shpenzimet e Personelit

Informata shtesë për ZRrE-ën lidhur me madhësinë stafit dhe regrutimin e fuqisë punëtore për vitin 2011.

KOSTT me aplikacionin për tarifa 2011 ka dhënë informata për rritjen e stafit për 25 punëtor. Në takimin e dt. 04.02.2011 ZRrE sikur nuk ishte i kënaqur me arsyetimet e prezantuara prandaj me këtë ofrojmë informata shtesë lidhur me këtë çështje.

Nisur nga organogrami i zhvilluar në vitin 2006 i prezantuar ZRRE-së gjatë aplikimit për licencë është paraparë që kur KOSTT të krijoj kushte të operoj me kapacitet të plotë duhet të ketë angazhuar një staf të madhësisë prej 288 punëtorëve. Ashtu si Ju kemi informuar në aplikacionin për tarifa, gjatë vitit 2010 KOSTT ka operuar me 215 anëtar të stafit.

KOSTT gjatë vitit 2010 nuk ka mund të rekrutoj staf të ri si pasojë e problemit të lokalit për operim të sistemit i cili përfundimisht është zgjidhur në fund të vitit 2010. Nga numri i përgjithshëm i vendeve të punës që duhet të plotësohen, 70% janë staf profesionist inxhinier, teknik dhe një numër i vogël ekonomist dhe jurist.

Arsyet që KOSTT gjatë vitit 2011 duhet të rekrutoj një numër prej rreth 30 personash të stafit inxhinierik, teknik dhe ekonomistësh, janë se KOSTT- tani më ka hyrë në fazat kur kërkohet të operoj me kapacitete më të mëdha se deri më tani në lëmin e :

1. Operimit të Sistemit si pasojë:

- e përfundimit të projektit të SCADA/EMS dhe telekomunikacionit;
- ndërrimit të regjimit të operimit dhe anëtarësimit në ENTSO-E që pritet të ndodh në një të ardhme të afërt

2. Operimit të transmisionit;

- Rritja e kapaciteteve në linja dhe nënstatione;

3. Operimit të Tregut:

- Tregu i energjisë po bëhet më real në kuptim të ristrukturimit që qeveria është duke zbatuar;
- Pozitës së re që KOSTT do ta fitoj në raport me interkoneksionin, me anëtarësimin në ENTSO-E

Prandaj, stafi një pjesë e të cilit është rekrutuar dhe do të rekrutohet do të dedikohet për mbulimin e kërkesave të lartpërmendura. Gjithashtu nga ky numër i të rekrutuarve pritet të zëvendësohen 6 anëtarë të stafit që nuk janë më në KOSTT (2 të vdekur, 2 të pensionuar dhe 2 që kanë lëshuar KOSTT-in) si dhe 4 anëtar të stafit që pritet të pensionohen gjatë vitit 2011.

Duke u nisur nga fakti se tregu i punës në Kosovë nuk ofron staf të përgatitur që mund t'i përgjigjet kërkesave specifike, KOSTT ka zgjedhur rrugën e rekrutimit dhe krijimit të marrëdhënies së punës me afat një vjeçar me inxhinier dhe ekonomistë, si dhe gjashtëmujor me teknik që t'i trajnoj dhe t'i

përgatis për marrjen e përgjegjësi në detyrat që mund të sistemohen. Mirëpo, KOSTT nuk do të hezitoj, që të mos vazhdojë kontratën nëse cilido nga ky staf i rekrutuar nuk do të përmbush kriteret e performancës së kërkuar.

**Tab. 1.** Kostoja e stafit në periudhën 2007-2011 dhe pjesëmarrja në të hyra:

	2007	2008	2009	2010	2011 - V.1	2011 - V.2
Të Hyrat e Lejuara	13,190	14,710	18,447	18,087	17,141	19,341
Shpenzimet e Personelit	1,460	2,057	2,272	2,495	2,878	2,878
Pjesmarrja e Sh.P. në Të Hyra	11%	14%	12%	14%	17%	15%

Nga të dhënat e tabelës shihet se kostoja mesatare e personelit 2007-2011 sillet prej **13.2%** deri **13.6%**.

- Fundi i dokumentit -